



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:116052  
Datë: 17.12.2024  
Numri i dokumentit: 06609517

CA.nr.839/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Hidajete Gashi Alaj, kryetare e kolegjit, Fatmir Baloku dhe Burim Shala, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses S.S.H., nga P., të cilin me autorizim e përfaqëson av.A.H. nga P., kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, të cilën e përfaqëson V. I. Xh., me objekt të padisë kompensimi i shujtave, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1459/23 datë 20.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.12.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1459/23 datë 20.10.2023, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.1459/23 datë 20.10.2023, ka vendosur si vijon: *“I.APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses S.S.H nga P.. II. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, që paditëses në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës për vitin 2022 prej datës 01.01.2022 deri 21.11.2022, për 163 ditë t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 326.00 (treqind e njëzet e gjashtë) euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga data e parashtrimit të padisë dt. 24.05.2023, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. III. DETYROHET e paditura që paditëses tia kompensoj shpenyimet e procedurës kontestimore në sumën prej 124 euro, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm ”.*

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë përfaqësuesja e autorizuar i të paditurës, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar

dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës si e bazuar dhe të priset aktgjykimi, dhe të hedhet poshtë padia e paditësit, të ndryshohet ose të priset aktgjykim dhe të kthehet në rivendosje në Gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar përfaqësuesi i paditëses S.S.H, av.A.H., duke propozuar qe te refuzohet ankesa e te paditurës dhe te vërtetohet aktgjykimi C.nr.1459/23 datë 20.10.2023.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditëses S.S.H, nga P., përmes të autorizuarve të tij av.A.H. nga P., pranë kësaj gjykate, me datën 24.05.2023, ka parashtruar padi, kurse me datë 16.10.2023 ka dorëzuar një parashtrësë për precizimin e kërkesëpadi së paditësit në kuptimin objektiv, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, me objekt të padisë kompensimin e shujtave.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave, si dhe të të gjitha shkresave tjera të lëndës, në bazë të nenit 398 të LPK-së, (jashtë seancës) ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.1459/23 datë 20.10.2023, me të cilin ka vendosur që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjyimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjyimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se gjykata përmes vërtetimit me nr.ref. 234/2023 i datës 21.09.2023 të lëshuar nga e paditura vërtetoi faktin se paditësja, është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht mësimdhënëse pranë SHFMU "Mustafa Baku" në Prizren dhe gjatë vitit 2022 e njëjta ka punuar gjithsej 163 ditë pune. Gjykata ia ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses në bazë të nenit 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021. Për kamatën ka vendosur bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në gjykatë, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020. Lidhur me shpenzimet ka vendosur në bazë të nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjyimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për Procedurën Kontestimore dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika o) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka gjykuar brenda kufijve të kërkesëpadisë së paditëses dhe nuk ka bërë tejkallim të kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në këtë procedurë kontestimore drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe atë nga vërtetimi me nr.ref. 234/2023 i datës 21.09.2023, vërtetoi faktin se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht mësimdhënëse në SHFMU “Mustafa Bakiu” në Prizren dhe gjatë vitit 2022 e njëjta ka punuar gjithsej 163 ditë pune.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjykuar për shpenzimet e ushqimit në punë, për arsye se: Me nenin 90 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *”Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet : a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) në nivel të ndërmarrjes”*. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 5 përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*.

Me nenin 35 paragrafi 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021 përcaktohet se: *“Të punësuarve, (anëtarë të SBAShK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditë e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy Euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensim për ushqim”*. Me nenin 45 paragraf 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: *“MASh, SBAShK dhe Ministria e Financave, angazhohen bashkërisht për t’i informuar dhe ndihmuar komunat, këshillat drejtuese të universiteteve dhe drejtoritë e shtëpive të studentëve që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe koston financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35. paragrafët 5, 7 dhe 11 kur të krijohen mundësitë financiare në buxhetin e Republikës së Kosovës, por jo më vonë se viti 2023“*.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditëses në emër të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: “Kreditore në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”.

Gjykata e Apelit, mori parasysh pretendimin ankimor të të paditurës lidhur me faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën, për arsye se nuk janë përmbushur kushtet e parapara të kësaj Kontrate, meqenëse nënshkruarit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare. Lidhur me këto pretendime, Gjykata e Apelit vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, përfshirë të drejtën për kompensim të ushqimit, i takon pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditëses, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë, ndërsa në nenin 2 par.1.2 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, ndër të tjera thuhet se: “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat - DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës...”, ndaj detyrimi për zbatimin e kësaj kontrate ka fuqinë ligjore.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 të LMD-së dhe llogaritja është bërë saktë në përputhje me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me kamatën.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Janë vlerësuar pretendimet ankimore të të paditurës, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
CA.nr.839/2024 datë 16.12.2024

Kryetare e kolegjit  
Hidajete Gashi Alaj, d.v.